



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Priljeño/Prodato Received/Delivery	13.12.2022	2	viti god year
Organ /Njësia Organ./Jedinitca Org./Unit	Nr Prot B: Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKMESHCK	8026/2022		1/6



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.959/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë, si dhe Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.959/2022 të datës 28.10.2022 të parashtruar nga ankuesi nga fshati

kundër organit të punësimit Këshillit të Sigurisë së Kosovës, në çështjen juridike "masë disiplinore-vërejtje", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 09.12.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.959/2022 e datës 28.10.2022, e parashtruar nga ankuesi

II. Mbetet në fuqi Vërejtja me numër protokolli 090/2022 e datës 20.10.2022 e shqiptuar nga Drejtori i Qendrës së Situatave në Këshillin e Sigurisë së Kosovës.

A r s y e t i m

Ndaj ankuesi i punësuar në Këshillin e Sigurisë së Kosovës, sipas Akt emërimit Nr.prot:13/2012 të datës 19.01.2012 në pozitën "Zyrtar i Lartë për Grumbullim dhe Përpunim të Informatave", në Qendrën e Situatave, me datën 20.10.2022 Drejtori i Qendrës së Situatave në Këshillin e Sigurisë së Kosovës në cilësinë e mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë i ka shqiptuar mase disiplinore „Vërejtje“ për shkak të mos njoftimit të eprorit të tij për zgjatjen e pushimit mjekësor dhe mungesën e tij në punë siç përcaktohet me Rregulloren (QRK) Nr. 12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publik.

Ankuesi i pakënaqur me Vërejtjen me shkrim të datës 20.10.2022 të shqiptuar nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë, me datë 28.10.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për mes emailit zyrtar ankesa.kpmshck@rks-gov.net, e regjistruar me numër A.nr.959/2022 me numër protokolli 6519/2022, me

pretendimet ankimore se vërejtja i është shqiptuar në kundërshtim me Ligjin Nr. 06/L-114 për Zyrat Publikë, për shkak se për caktimin e tij në kujdestari nuk ka qene në dijeni për gjatë pushimit mjekësor dhe ende pa e mbyll pushimin mjekësor dhe pa e dorëzuar raportin e mjekut, caktimi në kujdestarit për këtë periudha nuk është konform ligjit në fuqi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 18.11.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Sekretariati i Këshillit të Sigurisë së Kosovës, ndërsa Këshilli më datë 24.11.2022, ka pranuar përgjigje në ankesë nga Sekretariati i Këshillit të Sigurisë së Kosovës, së bashku me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 6519/2022 të datës 28.10.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për mes e-mailit zyrtar ankesa.kpmschck@rks-gov.net; Akt administrativ-Vërejtje me numër protokolli 090/2022 i datës 20.10.2022; Raport mjekësor-për ndërprerjen e përkohshme për punë nga data 07.07.2022 deri me datës 22.07.2022, i lëshuar nga QKMF; Raport nga Konsulta mjekësore-pa datë; Raport nga Konsulta mjekësore i datë 17.11.2020; Raport i mjekut 03.03.2021-rekomandim nga mjeku, me adres: Dallas me nënshkrim elektronik; E-mail i datës 26.10.2022 nga ankuesi për: ankesa.kpmschck@rks-gov.net; E-mail i datës 26.10.2022 nga ankuesi për z.SH.SH; E-mail i datës 26.10.2022 nga ankuesi z.SH.SH për ankuesin-Vërejtje; E-mail i datës 27.10.2022 nga ankuesi për KPMSHCK; Përgjigje ne ankesë e datës 24.11.2022 me numër protokolli 7367/2022, Akt emërimit nr.prot:13/2012 të datës 19.10.2012, Përshkrim i detyrave të punës e datës 13.01.2014; E-mail i datës 25.06.2022 nga z.F.I për z.SH.SH-Njoftim/kërkesë; E-mail i datës 12.06.2022 nga z.F.I për z.SH.SH -Njoftim/kërkesë; Raporti i datës 01.07.2022-31.07.2022 për prezencë në punë; kopje nga telefoni mobil i datës 07.07.2022 nga ankuesi ora 15:14; E-mail i datës 27.07.2022 nga z.V.G për z.SH.SH-Njoftim/kërkesë; Raport mos prezencë e kujdestarit ne QS data 23.07.2022, nga z.SH.SH Drejtor i QS, me raport te bashkangjitur; Deklaratë nga z.SH.SH; E-mail i datës 23.07.2022 nga Qendra Operative Komunikuese Koordinuese-DPP -Kërkesë për asistencë (qendraoperative@KosovoPolice.com); E-mail i datës 23.07.2022 nga Bravo kontroll MI për Qendra Operative Komunikuese Koordinuese-DPP -Kërkesë për asistencë (Kopje emaili); E-mail i datës 27.07.2022 nga z.M.K për z.SH.SH-Mungesë e kujdestarisë me dt.23.07.2022; E-mail i datës 27.07.2022 nga z. B.A. për z.SH.SH-Mungesë e kujdestarisë me dt.23.07.2022; E-mail i datës 07.07.2022 nga z.A.C për z.SH.SH-Mungesë e kujdestarisë me dt.23.07.2022; E-mail i datës 28.07.2022 nga ankuesi për z.SH.SH-Mungesë e kujdestarisë me dt.23.07.2022; Raport nga Konsulta mjekësore e datës 07.07.2022 prej ½ faqe; E-mail i datës 01.07.2022 nga adresa: printer.mr@rks-gov.net printer MF, për z.B.H. dhe ankuesin "RNP0026735B5E0A"; E-mail i datës 05.07.2022 nga adresa: printer.mr@rks-gov.net (printer MF) për z.M.K, ankuesin dhe z.SH.SH "RNP0026735B5E0A"; E-mail i datës 13.07.2022 nga -printer MF, për znj.F.I, ankuesin dhe z.SH.SH "RNP0026735B5E0A"; E-mail i datës 15.07.2022 nga- printer MF për z.B.A , ankuesin dhe z.SH.SH "RNP0026735B5E0A"; E-mail i datës 26.07.2022 nga- printer MF , për z.M.K , ankuesin dhe z.SH.SH "RNP0026735B5E0A"; E-mail i datës 27.07.2022 nga adresa printer MF , për z.M.K, ankuesin dhe z.SH.SH "RNP0026735B5E0A"; Qendra e Situatave-

orari i Kujdestarisë korrik 2022 i datës 01.07.2022; Qendra e Situatave- orari i Kujdestarisë korrik 2022 i datës 05.07.2022; Qendra e Situatave- orari i Kujdestarisë korrik 2022 i datës 08.07.2022; Qendra e Situatave- orari i Kujdestarisë korrik 2022 i datës 15.07.2022; Qendra e Situatave- orari i Kujdestarisë korrik 2022 i datës 27.07.2022; Përgjigje e datës 28.08.2022 me numër reference ref.10/ND-078-22 e lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë nga znj.N.K.D.- Inspektore shëndetësor për znj.F.I.-Menaxhere e personelit në DA-SKSK; E-mail i datës 12.09.2022 nga znj.N.K.D-sqarim shtesë për z.V.G, z.SH.O; E-mail i datës 09.09.2022 nga z.V.G për z.SH.SH-kërkesë për sqarim shtesë; E-mail i datës 09.09.2022 nga z.SH.O për z.V.G - kërkesë për sqarim shtesë; E-mail nga z.V.G për z.SH.SH Kërkesë për sqarim shtesë; E-mail i datës 03.08.2022 nga z.SH.O. për znj.F.I -Kërkesë; E-mail i datë 04.08.2022 nga znj.F.I për z.SH.O -Kërkesë; E-mail i datës 01.08.2022 nga znj.F.I. për z.S.O.-kërkesë; E-mail i datës 20.10.2022 nga ankuesi për z.SH.SH, znj.F.I., z.V.G,-masë disiplinore vërejtje, bashkangjitur raportet mjekësore në atth.; E-mail i datës 20.10.2022 nga z.SH.SH për ankuesin , znj.F.I, dhe z.V.G; Raporti elektronik të hyrjes në punë të datës 01.07.2022 dhe raportin elektronik të daljes nga puna të datës 02.07.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës konstatoj se ankesa e parashtruar nga ankuesi *është e pa bazuar, sepse:*

Bazuar në shkresat e lëndës Kolegji ka gjetur se ankuesi sipas Akt emërimit Nr.prot:13/2012 të datës 19.01.2012 është i punësuar në Këshillin e Sigurisë së Kosovës, në pozitën "Zyrtar i Lartë për Grumbullim dhe Përpunim të Informatave", në Qendrën e Situatave.

Drejtori i Qendrës së Sigurisë në Këshillin e Sigurisë së Kosovës, si mbikëqyrës i drejtpërdrejt i ankuesit më date 22.10.2022 ka nxjerr Vendim me nr. protokolli 090/2022 me të cilin ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore "Vërejtje" me arsyetim për shkak të shkeljeve disiplinore për mosrespektimin e orarit të rregullt të punës respektivisht për mos paraqitje në punë pas mbylljes së pushimit mjekësor me date 22.07.2022 si dhe për mos njoftim të eprorit të tij për zgjatjen e pushimit mjekësor siç përcaktohet me Rregulloren (QRK) Nr. 12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publik duke u bazuar se me datë 07 Korrik 2022, z. *ka qene ne vizite te mjeku dhe per shkak te gjendjes se tij shëndetësore mjeku i ka dhene pushim mjekësor ne afat kohor prej dy javësh. Sipas këtij raporti te mjekut te datës 07 Korrik 2022 është dashur te paraqitet me date 22.07.2022. Dhe ne bazë të këtyre të dhënave është përpiluar edhe orari i kujdestarisë për të cilin orar janë njoftuar të gjithë zyrtarët e Qendrës së Situatave, për mes e-mailit zyrtar nga adresa elektronike: printer.mr@rks-gov.net, ku sipas këtij orari me datë 23.07.2022 ka qenë i caktuar zyrtar i kujdestarisë gjatë ditës nga ora 08:00 deri në ora 16:00, kurse me datë 24.07.2022 ka qenë i caktuar kujdestar i natës. Mirëpo nuk është paraqitur në punë sipas raportit të datës 07.07.2022, me arsyetim se i është vazhduar pushimi mjekësor deri me date 25.07.2022 por nuk e ka informuar mbikëqyrësin e tij të drejtpërdrejtë dhe kjo ka rezultuar që Qendra e Situatave në Këshillin e Sigurisë së Kosovës, të mbese pa kujdestari ditën me date 23.07.2022 dhe pa kujdestari natën me date 24.07.2022.*

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës pretendon se Vendimi për masën disiplinore "Vërejtje" nga Drejtori i Qendrës së Sigurisë në Këshillin e Sigurisë së Kosovës e datës 22.10.2022 me numër protokolli 090/2022

është në kundërshtim të plotë me Ligjin Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik është nxjerrë në kundërshtim me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, duke theksuar se ka qenë në pushim mjekësor nga data 07.07.2022 deri me datë 25.07.2022 dhe nuk ka qenë në dijeni për orarin e kujdestarisë, pasi që në fashat ku jeton, nuk ka qasje në e-mail zyrtar, dhe se ai nuk është njoftuar as nga drejtori dhe as asistentja administrative lidhur me caktimin e tij në kujdestari, për me tepër unë jam caktuar në kujdestari sa kam qene në pushim mjekësor gjegjësisht jam caktuar në kujdestari pa e dorëzuar raportin e mjekut.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka analizuar pretendimet ankimore të ankuesit dhe provat e lëndës nga Njësia e personelit të Këshillit të Sigurisë së Kosovës, është konstatuar se pretendimet e ankuesit janë të pa bazuara sepse në provat e lëndës është vërtetuar se masa disiplinore e shqiptuar *"vërejtje me shkrim"*, me datë 20.10.2022 nga Drejtori i Qendrës së Situatave në Këshillin e Sigurisë së Kosovës, me numër protokolli 090/2022, është në pajtim me nenin 46 paragrafin 2 nën paragrafin 2.2 dhe paragrafi 4, nenin 47 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenit 48 paragrafin 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, që përcakton se: *"2.Shkeljet disiplinore ndahen në:.....2.2. shkelje të lehta"*, dhe paragrafi 4. *"Shkelje të lehta konsiderohen: 4.1. mungesa e paarsyeshme në punë deri në dy (2) ditë pune"* neni 47 paragrafi 1 *"Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: "1.1. vërejtje"*, dhe neni 48 të këtij ligji, *"1. Masa disiplinore e parashikuar në paragrafin 1.1 të nenit 47 të këtij ligji jepet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë"*, lidhur me faktin se ankuesi në bazë të planit të orarit të kujdestarive për muajin korrik 2022, është njoftuar me datë 01.07.2022 me numër protokolli QS-KSK 213, për mes emailit zyrtar nga sistemi elektronik e-maili adresa: printer.mf@rks-gov.net, dhe i njëjti me këtë datë ka qenë në punë, dhe se pretendimi i ankuesit është i paqëndrueshëm lidhur me mos njoftimin për orarin e kujdestarive për muajin korrik 2022, gjegjësisht pretendimi i tij, kinse ka qenë në pushim mjekësor se në fshatin e tij, dhe nuk ka pasur mundësi të hap adresën elektronik e-mailin zyrtarë, duke shtuar se sipas raportit mjekësor të datës 22.07.2022, ka qenë në pushim mjekësor, nga data 07.07.2022 deri me datë 25.07.2022, nuk qëndron, sepse ankuesi me datë 01.07.2022 kur është njoftuar për orarin e kujdestarive, ka qenë në punë dhe ka qenë në dijeni për orarin e kujdestarive, pasi që njoftimi për orarin e kujdestarive është shpërndarë për të gjithë zyrtarët e Qendrës së Situatave, për mes adresë: printer.mf@rks-gov.net, ku ka qenë dhe ankuesi i përfshirë, të cilën e konfirmon dhe njësia e personelit në përgjigjen në ankesë duke theksuar se, citoj : *"..... me datë 01.07.2022 ka qenë në vendin e punës në ndërrimin e natës nga ora 20:00 deri të nesërmen (02.07.2022) në ora 08:00"*, dhe po ashtu me dëshmi të raportit elektronik të hyrjes në punë të datës 01.07.2022 dhe raportin elektronik i daljes nga puna me datës 02.07.2022 (nga orari i kujdestarisë), ndërsa lidhur me pretendimin ankimor se ankuesi është caktuar në kujdestari sa ka qenë në pushim mjekësor nuk qëndron sepse orari për caktimin në kujdestarinë muajit korrik është njoftuar në fillim të muajit korrik respektivisht me datë 01.07.2022, para se me hy ankuesi në pushim mjekësor, Kolegji në bazë të shkresave të lëndës të dorëzuara nga organi i punësimit dhe ankuesi, konstaton se është i pretendimet e ankuesit janë të pa qëndrueshëm sepse ankuesi me date 07.07.2022 e ka njoftuar përmes viberit mbikëqyrësin e tij të drejtpërdrejtë se gjendet në pushim mjekësor duke ja bashkangjitur si foto edhe raportin e mjekut te datës 07.07.2022.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit ka marrë për bazë përgjigjen e datë 28.08.2022 me numër reference 10/ND-078-22 e lëshuar nga znj.N.K.D.-Inspektore shëndetësor në Ministrinë e Shëndetësisë, lidhur me kërkesën e datës 01.08.2022 të Menaxheres së Personelit në DA-SKSK/Këshillit të

Sigurisë së Kosovës, përmes e-mailit zyrtar, drejtuar Zëvendësuesit në Detyrë të Kryeinspektorit Shëndetësor, në Ministrinë e Shëndetësisë, për verifikimin e pushimit mjekësor sipas procedurës standarde të datës 22.07.2022 me numër amëze 13787 (lëshuar nga Qendra e Mjekësisë Familjare në Skenderaj), e cila ka dhënë këtë përgjigje, citoj:'

ishte evidentuar në regjistër të pacientëve me datë 07.07.2022 me nr. rendor 12931 me diagnozë E 11,98F 48/8 dhe terapi si dhe me datë 22.07.2022 me nr.rendor 13787. Sipas deklaratës së Dr.O.V./Specialist i Mjekësisë Familjare në QKMF-Skenderaj, mospërputhja e datave në raportin e Ndërprerjes së Përkohshme për Punë është gabim teknik, pra pacienti Rexhep Lushtaku i është përshkruar pushimi nga data 07.07.2022 deri me datë 22.07.2022. Data 25.07.2022 e cila figuron në raport për Ndërprerje të Përkohshme për Punë është gabim teknik,.....Inspektori Shëndetësor pas inspektimit dhe analizimit të rastit dhe rekomandimet janë bazuar në Ligjin për Shëndetësinë Nr.04/L-125". Për të cilën çështje znj.N.K.D-Inspektorja e Shëndetësisë për mes e-mailin të datës 13.09.2022, ka dhënë sqarim shtesë dhe Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Sigurisë së Kosovës, sipas kërkesës së tij, E-mailit të datës 09.09.2022, duke shtuar se, citoj: "Bazuar në inspektimin e kryer të datës 10.08.2022 në QKMF-Skenderaj, Inspektorati Shëndetësor duke u bazuar në dokumentacionin shëndetësorë dhe deklaratën e Dr.O.V., ka konstatuar se pushimi mjekësor për pacientin është hapur me datë 07.07.2022 dhe është mbyllur me datë 22.07.2022, pra pushimi mjekësor përfundon me datë 22.07.2022".

Andaj, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, lidhur me konstatimin e gjendjes faktike se ankuesit pushimi mjekësor i ka filluar nga data 07.07.2022 dhe i ka përfunduar me datë 22.07.2022, dhe se data 25.07.2022 e cila datë figuron në raport për ndërprerje të përkohshme për punë është gabim teknik, e që ankuesi e ka pretendim se me rekomandim të mjekut i është vazhduar pushimi mjekësor deri me datë 25.07.2022, ky pretendim nuk qëndron, sepse ne baze të shkresave të lendes është vërtetuar se data 25.07.2022 është gabim teknik, gjegjësisht nga mjeku Dr.O.V është dëshmuar nga se pushimi mjekësor për ankuesin ka përfunduar me datë 22.07.2022, andaj siç u vërtetua si më lartë ankuesi ka qenë i obliguar, që nga data 23.07.2022 të paraqitet në vendin e punës, ashtu siç përcaktohet me nenin 9 paragrafin 1, 5 dhe paragrafin 6 të Rregullores Nr.07/2022 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publik(e publikuar në Gazetën zyrtare të datë 05.10.2022), ku theksohet se "1. Gjatë orarit të punës të gjithë zyrtarët publik janë të obliguar të jenë prezent në vendin e punës..... 5. Mos respektimi i orarit të punës, sipas Ligjit përkatës për Zyrtarët Publik paraqet shkelje disiplinore", dhe paragrafi 6. "Për çdo largim nga vendi i punës gjatë orarit, zyrtari publik duhet të marrë leje të mbikëqyrësi i drejtpërdrejt", që në fakt ankuesi në ditën e caktuar të kujdestarisë nuk është paraqitur në punë, respektivisht në vikendin e datës 23.07.2022 gjatë ditës dhe në vikendin e datës 24.07.2022 i caktuar në orarin e natës, andaj ne rastin konkret mos prezenca e ankuesit në vendin e punës gjegjësisht mos respektimi i orarit të punës paraqet shkelje disiplinore siç parashihet me paragrafin 2 të nenit 8 të Rregullores (QRK) Nr.12/2020 Për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publik,

Nisur nga rrethanat si më lartë Kolegji vlerëson se mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i ankuesit me rastin e shqiptimit të masës disiplinore "Vërejtje" sipas Vendimit me Nr. Prot:090/2022 të datës 22.10.2022, ka konstatuar saktë përgjegjësinë disiplinore të ankuesit si dhe ka cilësuar drejtë veprimet e ankuesit si shkelje të lehtë disiplinore siç përcaktohet me nenin 46 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik si dhe nenin 48 paragrafi 2 të të njëjtit ligj më të cilin është përcaktuar se: "Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë detyrohet të fillojë procedurën disiplinore mbi bazën e fakteve konkrete dhe të provuara për shkeljen e detyrimeve nga nëpunësi civil", sepse zyrtari

publik ka detyrimin të veprorë në përputhje me urdhrat e marrë nga mbikëqyrësit e tij, sipas ligjit dhe rregullave të brendshme të institucionit siç parashihet me nenin 26 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik.

Andaj Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i ankuesit me rastin e shqiptimit të masës disiplinore ka vepruar në pajtim me nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, nenin 48 paragrafi 1, 50 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe në pajtim me nenin 8 paragrafin 2 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, duke e arsyetuar vendimin në pajtim me Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative, gjegjësisht me nenin 48 paragrafi 1 dhe të 2, andaj sa i përket pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se të gjitha pretendimet ankimore të ankuesit janë të pabazuara dhe të paqëndrueshme sepse i njëjti nuk i ka argumentuar me prova relevante.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Iniciumi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.959/2022.

Zyler **MILLAKU GOJNOVCI**

Procesmbajtëse

Malsore **GASHI BAJRAKTARI**

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Sigurisë së Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Këshillit të Sigurisë së Kosovës dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së.